

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil,
sipas gjyqtarit, Halil Zahiri, në çështje juridiko civile të paditësit, nga Gjilani,
Rr. ,, ,, nr. i përfaqësuar prej av. ,, nga Gjilani, ndaj të paditurve
nga Gjilani, Lagja nr. Rr. ,, ,, (Rruga qarkore),
nga Gjilani Rr.,,, ,, nr. dhe ,, nga f. Komuna e
sipas të autorizuarit, ,, nga f. ,, për vërtetimin e të drejtës së pronësisë,
në seancën kryesore dhe publike të mbajtur më dt. 11.05.2018 bie këtë

AKT GJYKIM

Në bazë të pohimit-pranimit

I. APROVOHET si e bazuar, kërkesëpadia e paditësit, ,, ndaj të paditurve, ,, e dhe **VËRTETOHËT** se paditësi është pronarë i pasurisë së paluajtshme përkatësisht sipërfaqes prej 0.05.00 ha, pas ndarjes fizike, e formuar si ngastër e re kadastrale nr.P. ,, prej ngas.kad.nr.P. ,, e cila e ka kishte sipërfaqen prej gjithsejt 0.23.29 ha, gjendet në v.q. " " e regjistruar sipas Çertifikatës nga lënda nr.1038-2017, (e lëshuar më dt.07.02.2017 nga DGJKP në Gjilan), ndërsa ngastra bazë nr.1782-0 do ta merr numrin e ri 1782-1 dhe sipërfaqja e saj do të mbetet prej gjithsejtë prej 0.18.29 ha, në bashkëpronësi në emër të të paditurit, ,, për 1/3 e pjesës ideale dhe në emër të për 2/3 e pjesës ideale, ashtu që sipërfaqja prej 0.05.00 ha, pas daljes në vendin e ngjarjes si ngastër e re kadastrale nr.1782-2, është e ndarë dhe e formuar nga 1/3 e pjesës ideale që i takon të paditurit ,, nga f. ,, Komuna e

II. DETYROHEN të paditurit të durojnë dhe të ia njohin paditësit të drejtën e pronësisë për sipërfaqen e cekur më lartë ashtu që ,, në DGJKP të Gjilanit do të evidentohet si pronarë i pasurisë kontestuese, këtë në afat prej 15 ditësh, pas ditës së plotfuqishmërisë të këtij Aktgjykimi me vërejtje të përmbartimit të detyruar.

II. Në bazë të nenit 450, të LPK-ës, gjykata vendosi që secila palë ti bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

A r s y e t i m

Paditësi, ,, nga Gjilani, me padinë e ushtruar kësaj gjykate më dt.13.02.2017, ka konfirmuar se në vitin 2003, sipas kontratës verbale me të paditurin e parë ,, e ka blerë sipërfaqen prej 0.05.00 ha, prej ngas.kad.nr.1782-0, për çmimin kontraktues në lartësi prej 12.500 €, pasi që blersëi ,, ia kishte dorëzuar shumën e të hollave shitësit ,, /pronari faktik/, me rastin e pranimit të shumës së të hollave në emër të çmimit kontraktues ja ka dorëzuar paditësit tani blersëit sipërfaqen prej 5 ari në pronësi faktike, shfrytëzim të ligjshëm dhe me mirëbesim.

Përfaqësuesi i paditësit av. ,, nga Gjilani, në seancën kryesore të mbajtur më dt.11.05.2018 dhe seancat tjera deklaroi se qëndroj pranë padisë dhe i propozoj gjykatës që të dëgjohen palët ndërgjyqëse, të dal gjyqtari me ekspert gjeodet në vendin e ngjarjes me palët ndërgjyqëse për ta vërtetuar gjendjen faktike në teren, e pas administrimit të gjitha provave nga lënda i propozoj gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta aprovoi në tërësi si të bazuar.

Të paditurit, dhe e kanë pranuar padinë me kopje të aktvendimit për dhënien e përgjigjes në padi me çka vërtetohet në bazë të fletë dërgesave, ndërsa i padituri me dt.15.03.2017 ka ushtruar përgjigje në padi me të cilën ka konfirmuar se në tërësi e ka pohuar dhe pranuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar.

Në seancën kryesore të mbajtur më dt.11.05.2018, i autorizuari i të paditurit nga f. deklaroi se në emër të paditurit , konfirmoj rrethanën se paditësi pasurinë kontestuese e ka blerë për çmimin kontraktues në lartësi prej 12.500 €, prej të paditurit të parë, pasi e ka përmbushur në tërësi detyrimin kontraktues përkatësisht pasi i ka dorëzuar shumën e parave shitësit i cili ia ka dorëzuar blerësit në shfrytëzim pasurin kontestuese, i pa penguar nga të paditurit apo personat tjerë për faktin se këtë pasuri më parë e kishte blerë prej kurse këtë pasuri e ka blerë prej gjyshit të emër të të paditurit të tretë, ne deklarojmë se e pohojmë dhe e pranojmë kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, pajtohem me propozimin e përfaqësuesit të paditësit se gjykata me ekspert gjeodet të del në vendin e ngjarjes për ta identifikuar sipërfaqen kontestuese se ku gjendet dhe që duhet të ndahet prej sipërfaqes që i takon dhe ate 1/3 e pjesës ideale të paditurit të tretë nga f. , e pas identifikimit të kësaj sipërfaqe të bëhet ndarja fizike ashtu që sipërfaqja e blerë nga paditësi prej 0.05.00 ha, pas ndarjes fizike në vendin e ngjarjes do ta merr numrin e ri e që do të regjistrohet si ngastër e re kadastrale në DGJKP në Gjilan, në emër të paditësit.

Në seancën pregaditore të mbajtur më 25.01.2018, i padituri i parë ka deklaruar se pasurinë kontestuese ia kam shitur paditësit për çmimin kontraktues në lartësi prej 12.500 €, pasi blerësi ia ka dorëzuar shumën e parave, shitësi ia ka dorëzuar pasurinë kontestuese blerësit në shfrytëzimin e qetë në cilësi të pronarit faktik, i pa penguar nga shitësi dhe familja e tij. Pajtohem që të dal gjyqtari me ekspert gjeodet në vendin e ngjarjes, me palët ndërgjyqëse, ndërsa në këtë fazë të procedurës deklaroi se e pranoj dhe e pohoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar.

I padituri i dvtë deklaroi se pasurin kontestuese më parë e ka blerë prej trashëgimtar i vetëm i gjyshit të ky u fundit i padituri i tretë që është unë ia pohoj dhe pranoj kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar dhe pajtohem me propozimin e palës paditëse se gjyqtari i çështjes të del me ekspert gjeodet në vendin e ngjarjes për ta konstatuar gjendjen faktike në teren.

I padituri i tretë sipas të autorizuarit të tij , deklaroi se paraprakisht pajtohem me propozimin e paditësit, se gjyqtari me ekspert gjeodet të dal në vendin e ngjarjes dhe palët ndërgjyqëse, ti vendos pikat e kufirit për sipërfaqen prej 5 ari që e ka blerë paditësi, në emër të paditurit të tretë e pranoj dhe e pohoj kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të bazuar.

Në seancën kryesore të mbajtur më dt.11.05.2018 eksperti gjeodet, i nga Gjilani deklaroi se ngas.kad.nr. në sipërfaqe prej 0.23.29 ha, është e regjistruar në emër të bashkëpronarëve të cekur si në Çertifikatë të pronës, ne në vendin e ngjarjes e kemi ndarë sipërfaqen prej 0.05.00 ha, nga 1/3 e pjesës ideale që i ka takuar të paditurit nga f. dhe për këtë sipërfaqe është formuar ngastra e re kadastrale sipas nr.1782-2, ndërsa ngastra bazë ka mbetur në sipërfaqe prej 0.18.29 ha, dhe numri i saj ka mbetur 1782-1.

Palët ndërgjyqëse nuk kanë pyetje dhe vërejtje në konstatimin me skicë të hartuar nga vendi i ngjarjes prej ekspertit gjeodet.

Në bazë të nenit 8 të LPK gjykata i ka lexuar dhe administruar të gjitha provat nga lënda si vijon:

- Lexohet dhe administrohet Çertifikata sipas lëndës nr. 1038-2017, e lëshuar më dt.07.02.2017 nga DGJKP, në Gjilan. Nga kjo provë gjykata konstaton se ngastra kadastrale nr.1782-0 është e regjistruar në bashkëpronësi për 1/3 e pjesës ideale në emër të dhe për 2/3 pjesës ideale në emër të dhe është konstatuar se sipërfaqja e tërë ngastrës bazë përputhet me të dhënat nga elaborati kadastral.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i paditësit dhe paditësit personalisht deklaruan se qëndrojmë pranë padisë dhe i propozojmë gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta aprovoi në tërësi si të bazuar.

I padituri i parë dhe i dytë, kishin deklaruar se e kanë pranuar dhe pohuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit.

I autorizuari i të paditurit të tretë në fjalën përfundimtare deklaroi se e pranoj dhe e pohoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar.

Gjykata pasi e ka marr konfirmimin prej të paditurve se ata e kanë pohuar dhe pranuar kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të bazuar, në bazë të nenit 73 të LMD-ës së aplikueshme, e konvalidoj kontratën verbale të lidhur në mes paditësit dhe të paditurit të parë, pasi të gjithë të paditurit e kanë pohuar dhe pranuar kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të bazuar dhe në bazë të nenit 148 pik. 1, lidhur me nenin 388 të LPK-ës, gjykata bie Aktgjykim në bazë të pohimit dhe pranimit.

Në bazë të nenit 450 të LPK-ës, palët ndërgjyqëse janë deklaruar që secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurës kontestimore.

Nga të cekurat më lartë në bazë të nenit 73 të LMD-ës dhe nenit 148 pik. 1, lidhur me nenin 388 të LPK-ës, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Gjyqtari
Halli Zahiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 15 ditësh, pas ditës së pranimit të të njejtit. Ankesa dorëzohet në kopje të mjaftuara përmes kësaj gjykate.